



**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**SPITALI RAJONAL DURRËS**

NR. Prot \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Frigorifer morgu me 2 vende te vecante për Spitalin Rajonal Durrës”

Nr	ARTIKULLI	PERSHKRIMI	Njesia	Njesia
1	Frigorifer Morgu	Frigorifer morgu me 2 vende te vecante	Cope	1

Numri i referencës së procedurës **REF-89779-12-05-2023**

**Fondi limit ne total: 1,633,333.3** (Nje milion e gjashtëqind e tridhjet e tremije e treqind e tridhjet e tre pik tre ) Leke, pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Durrës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

**b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;**

**Argumentimi:** Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

**c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

**d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

---

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera e tyre te jete jo me e vogel se 40 % e vlerës së fondit limit te lotit ose shumes se loteve për të cilat konkurron operatori. Kërkesa konsiderohet e permbushur nese operoret ekonomik arrijne vleren e xhiros minimale ne te pakten 1 vit te periudhes se kerkuar.*

**Argumentimi:** Ky kriter (pika a dhe b), eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.

Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar sipas **nenit 43 pika 2/c dhe te nenit 55 pika 4 te VKM nr. 285 date 19.05.2021** “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku percaktohet si me poshte:

#### **Neni 43**

##### ***Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare***

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) **40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit** , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

#### **Neni 55**

##### ***Procedurë e hapur e thjeshtuar***

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. **Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

**Argumentimi:** Ky kriter vihet në përputhje me pikën 2 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike :Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

2. Të vërtetojë që ka të paktën 1 (nje) Inxhinier në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore i cili do të kryej furnizim vendosjen e pajisjes dhe aksesoret përkatës objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave së trajnimit sipas aparatures që furnizon, CV-së, kontratës individuale të punës. Inxhinjeret duhet të figurojnë në listpagesa në 3 muajt e fundit para dates se hapjes se tenderit.

\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës të DST.

### Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

**Argumentimi:** Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

- 3.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtoje pajisjet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

**Argumentim:** Ky kriter vihet në përputhje me piken 1 të nenit 77 (aftësia teknike) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe me pikën 2 të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

4. Ofertuesi duhet të paraqese për pajisjen mjekesore objekt prokurimi, çertifikaten CE ose deklaratën e konformitetit (sipas kategorizimit perkates) për aprovim të standarteve, direktivave në tregun Europian, origjinal i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të percaktuar se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të*

*njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjën mbështetje në rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të çilesisë”.

5. Ofertuesi duhet të paraqesë autodeklarate që pajisja e shoqëruar me aksesoret përket objektit prokurimi të jenë të reja, të përdorura dhe prodhim i viteve të fundit (2021-2023).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pikë 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të çilesisë”.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë për pajisjet, në të cilën duhet të saktësojë se periudha e garancisë të jetë jo më pak se 1 (një) vit, sipas afatit të përcaktuar në specifikimet teknike. Në deklaratën për përmbushjen e afatit të garancisë (një vit garanci përfshirë blerjen edhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pikë 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në pikat 5, 6 dhe 8 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të çilesisë”.

7. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e përcaktuar se: [...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përpuethshmerisë së paisjeve mjekesore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen objekt prokurimi bashkë me aksesoret përkatës, në formë tabelle, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit. **(Sipas Formularit të Vetedeklasimit)**

**Argumentimi:** Ky kriter është në përputhje me **piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik"**, në të cilën është e përcaktuar se:

*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorhet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor dhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 2 të nenit 40 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me anë të së cilës do të bëhet e mundur verifikimi me i saktë i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

8. Operatori do të paraqesë katalogun e pajisjes ku të jen shënuar (markuar) specifikimet teknike.  
**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pikë 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve e konomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*
9. Operatori do të kryejë furnizimin, instalimin dhe testimin e aparaturave me kostot e tij.
10. Operatori duhet të trajtojë stafin mjekësor pas instalimit të pajisjeve mjekësore në pavionet përkatëse

**Keto kritere dhe argumentime janë bërë dhe janë vendosur në bazë të materialit të specifikimeve teknike të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdherin e brendshëm me nr..... prot., datë 30.11.2023.**

11. Afati i lëvrimin të jetë 45 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**



Nr	ARTIKULLI	PERSHKRIMI	Njesia	Njesia
1	Frigorifer Morgu	Frigorifer morgu me 2 vende te vecante	Cope	1

#### SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Frigoriferi do të ketë një kapacitet prej 2 vende te vencaten, me hapje perpara terthorazi.
2. Madhësia e njësisë së morgut do të jetë 860 mm x 2400 mm x 1700 mm me tolerance +10%. Dimensionet e brendshme të dhomes së njësisë; Lartësia do të jetë së paku 500 mm dhe gjerësia se paku 660 mm
3. Pjesët e brendshme dhe të jashtme të njësisë do të jenë prej çeliku inoks cilësor Trashësia e materialit të veshjes së jashtme do të jetë së paku 0,6 mm, dhe veshja e brendshme do të jetë së paku 0,60 mm. Kjo veçori do të dokumentohet nga Prodhuesi.
4. Izolimi i mureve anësore, mureve të poshtme, të sipërme dhe të pasme duhet të jetë së paku 78 mm, dhe raftet e ndërmjetme duhet të jenë të paktën 38 mm.
5. Njësia do të ketë 2 Kapake. Të gjitha kapakët do të prodhohen nga materiali Celik inox
6. Frigoriferi duhe te kete treguhes digital per secilen dhome te pavarur.
7. Grupet e ftohjes do të kenë një sistem shkrirjeje dhe rregullimi i kohës së shkrirjes do të jetë i mundur nëpërmjet ekraneve dixhitale.
8. Ftohësi i njësisë duhet të jetë në gjendje të rregullojë dhomen në të cilën ndodhet trupi midis 4 dhe -18 gradë.toleranca +/- 10%
9. Sistemet e ftohjes së dy dhomave të veçanta në njësi do të projektohen për të funksionuar në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Në këtë drejtim, izolimi i 2 dhomave të veçanta në njësi do të izolohet për të parandaluar përshkueshmërinë e nxehtësisë si nga mjedisi i jashtëm ashtu edhe nga dhomat me njëra-tjetrën.
10. Ftohësit do të funksionojnë me tension 220 V
11. Secila dhome do te ket vrima te vencanta per shkarkimin e ujit
12. Secila dhome do te kete tave dhe shtreter funeral te vencante
13. Duhet të ketë një sistem transportues për të hequr enët funerale nga morgu.
14. Sistemi transportues duhet të përbëhet nga 2 pjesë. Trupi dhe rrotat
15. Sistemi transportues duhet të prodhohet pa saldim. Në këtë mënyrëqë ngarkesa bakteriale Brenda dhomes te minimizohet
16. Tavat funerale duhet te jene flete me materialin Celik Inox me trashesi 1.2 mm +/- 10%
17. Permasat e tavave duhet te jene 600 mm x 1900 mm me tolerance +/- 5%
18. Tavat funerale do të kenë nga 2 (dy) doreza mbajtëse në secilen ane.
19. Tavat funerale duhet të mbajnë një ngarkesë prej të paktën 150 kg.
20. Afati i lëvrimin të jetë 45 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës

**Argumentimi per specifikimet teknike:** jane vendosur si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b te Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”,nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

## FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: *Sipas tabelës së mëposhtme.*

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit të jetë 45 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës

Nr	ARTIKULLI	PERSHKRIMI	Njesia	Njesia
1	Frigorifer Morgu	Frigorifer morgu me 2 vende te vecante	Cope	1

Sasia dhe Grafiku i levrimit jane vendosur ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike me nr. 1595/3 date 01.12.2023 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 1595/1 date 30.10.2023 , si dhe ne perputhje me piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

### U ngarkua ne sistemin e prokurimit elektronik nga njesia e prokurimit:

Edison Rapi

Pergjegjes i Sektorit te Prokurimit Publik

Edlin Karaboja

Specialist i sektorit te teknologjise

Enis Karaj

Specialist i larte i Sektorit te prokurimit publik